



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER MARGALINA Y. DAUTI
ADRESA Rruga "Muhamet Gjollësja,
Pall. Moskat, shk 3, ap 14"
TEL: 692204572



PROKURË E POSAÇME

Nr. repertori: 4206

Nr. koleksioni: 2316

Tirane më 04/09/2023

Margalina
Dauti

Firmosur elektronikisht nga
NISA me certifikaten
:Margalina Dauti
Data: 2023.09.04
16:25:25+02:00

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar

*Akti noterial përbëhet nga 2 fletë



A2023050360258011837



PROKURE E POSAÇME

Sot, më datë 04/09/2023, para meje Notere MARGALINA Y. DAUTI, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore Tiranë, me zyrë në adresën: Tiranë, Rruga. "Muhamet Gjollësja", Pallati Moskat, Shk. 3, Ap. 14, u paraqit personalisht:

I PERFAQESUAR: Z.AKAN AJDINI, shtetas shqiptar, lindur me 24.02.1979 në Tiranë, dhe banues në Tiranë, identifikuar me anë të Letërnjoftimit me nr. serial 034136572 dhe nr. personal H90224173T, lëshuar më datë 16.04.2016 nga M.B. në cilësinë e **Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv / Administratorit të shoqërisë IuteCredit Albania sha**, një shoqëri aksionare, që vepron si Institucion Financiar i Mikrokreditë bazuar në Licensën e lëshuar nga Banka e Shqipërisë Nr. 32, datë 31.03.2015, themeluar sipas legjislacionit shqiptar në fuqi, regjistruar në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB), me NUIS L42011023U, dhe seli në: Rr. A. Z. Cajupi, Nd. 3, H. 2, 1001, Tirana, Shqipëri,

I cili me dëshirë të lirë, vullnet të plotë dhe të pa vesuar, kërkoj nga unë Noterja redaktimin e kësaj prokure të posaçme në bazë të neneve nr. 64, 70 e vijues të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, neni 62, neni 99 i ligjit 110/2018 "Për Noterinë", si më poshtë vijon:

Unë i përfaqësuari i mësipërm, Emëroj si përfaqësues të posaçëm **Ervin Peçuni**, atësia Filip, amësia Donika, shtetas Shqiptar, lindur në Gjirokastrë dhe banues në adresën Mehmet Brocaj Nr.; Nd. 10; Njësia Administrative Nr. 9; Njësia Bashkiake Nr. 9; 0000; Tiranë, i datëlindjes 25/07/1981, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Letërnjoftim ID nr. 035256969 dhe nr. personal I10725132M

I cili ka të drejtë të veprojë në emër dhe për llogari të të Përfaqësuarit gjatë mungesës së tij, duke kryer veprimet përfshirë por pa u kufizuar si vijon:

- Të nënshkruajë, ndryshojë, transferojë apo përfundojë / zgjidhë kontrata më palët e treta si: kontrata kredie në të cilat shoqëria IuteCredit Albania sha ka cilësinë e kredidhënësit apo kredimarrësit, kontrata qiraje, kontrata blerje / furnizimi si dhe cdo kontratë tjetër me Partnerë të rinj apo ekzistues të shoqërisë IuteCredit Albania sha.
- Të përfaqësojë shoqërinë IuteCredit Albania sha pranë autoriteteve publike përfshirë por pa u kufizuar: Autoritetet Mbikqyrëse (Banka e Shqipërisë, Agjencia e Inteligjencës Financiare, Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare, etj), Autoriteteve Tatimore, (Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtoritë Rajonale Tatimore, Drejtoritë e Taksave dhe Tarifave Vendore,) Bashki, Njësi Administrative, Organeve të Drejtësisë (Prokurori dhe Gjykata të të gjithë instancave, juridiksioneve, kompetencave lëndore dhe territoriale, Qendrës Kombëtare të Biznesit, si dhe cdo institucioni tjetër publik apo privat i përmendur në menyrë eksplicite në këtë prokurë.
- Të përfaqësojë Shoqërinë IuteCredit Albania sha pranë bankave të nivelit të dytë në Republikën e Shqipërisë, për kryerjen e veprimeve bankare, në emër dhe për llogari të shoqërisë si: depozitime, tërheqje, transfertë në favor të paleve të treta, brënda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë pa limit në shumë apo monedhë, këmbime valutore, pagesa, online banking, mbyllje të llogarive bankare si dhe cfarëdolloj veprimi tjetër të kërkuara nga bankat me qëllim realizimin e tagrave sikurse përmendur në këtë paragraf..
- Të aprovojë dhe nënshkruajë të gjitha urdherat e shpenzimeve / fatura bazuar në buxhetin vjetor të aprovuar më parë nga organet kompetente të shoqërisë.
- Në përgjithësi, Përfaqësuesi mund të kryejë cfarëdolloj veprimi tjetër në emër dhe për llogari të të Përfaqësuarit, me përjashtim të atyre veprimeve dhe kompetencave që duhet të ushtrohen ekskluzivisht nga Administratori, bazuar në Legjislacionin Shqiptar në fuqi dhe Statutin e Shoqërisë.



A2023050360258011837

Kjo Prokurë e Posaçme lëshohet në përputhje me Ligjin Nr. 9901 date 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar, si dhe Nenin 19 paragrafi 3 i Statutit të Shoqërisë.

Përfaqësuesi nuk ka të drejtë të delegojë tek një personi i tretë, tagrat sipas kësaj prokure, me përjashtim të atyre të përmendura në paragrafin b) më sipër.

Kjo Prokurë e Posaçme do të jetë e vlefshme për një periudhë kohe të pacaktuar, deri në revokimin e saj por në çdo rast, do të shoqërohet nga një Autorizim jo-noterial lëshuar nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv, me të cilin do të përcaktohet periudha e mungesës, gjatë së cilës mund të veproje Përfaqësuesi sipas kësaj Prokure.

Çdo veprim i kryer nga Përfaqësuesi në përputhje me tagrat e dhëna sipas kësaj Prokure të Posaçme do të konsiderohet i mirëqënë sikur të ishte kryer personalisht nga i Përfaqësuari. Për veprimet e kryera nga Përfaqësuesi në tejkallim të tagrave sipas kësaj Prokure të Posaçme dhe për më tepër, në dëm të interesave të të Përfaqësuarit, do të konsiderohen të kryera në keqbesim dhe në kapërcim të tagrave të deleguara.

Unë Noteri deklaroj se të gjitha të dhënat personale të personave në këtë dokument do të jenë konfidenciale dhe do të përdoren vetëm për qëllim të redaktimit të këtij akti, në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr.9887, datë 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" I ndryshuar si dhe cdo akt nënligjor në bazë dhe për zbatim të tij.

Kjo Prokurë e Posaçme u hartua nga unë Noteri në 4 (katër) kopje origjinale me të njëjtën vlerë ligjore, dhe iu lexua me zë të lartë të Përfaqësuarit, i cili deklaroi se e kuptoi dhe e nënshkroi rregullisht, me vullnet të lirë e të pavesuar para meje Noterit.

I PËRFAQËSUARI

IuteCredit Albania sha

AKAN AJDINI

Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv



NOTERE

MARGALINA Y. DAUTI

